

Udhëzues për prindër, për bashkëpunim dhe për rregullat e shkollës

1. Secili prind ka të drejtë të marrë informata për fëmijën e vet, në çdo kohë, në përputhje me rregullat e shkollës.
2. Informimi i vazhdueshëm mund të bëhet përmes thirrjes telefonike ose komunikimit elektronik (me e-mail, ditari elektronik i nxënësit, fletorja e komunikimit të klasat 1-5, etj.).
3. Takimet e prindërve me stafin e shkollës duhet të jenë të paralajmëruara dhe ato caktohen me marrëveshje.
4. Ardhja e prindërve në shkollë pa paralajmërim shoqërohet nga sigurimi i shkollës, derisa mësuesi mund ta konfirmojë takimin e mundshëm. Në rast të vizitave, prindërit duhet të jenë të shoqëruar nga stafi i shkollës.
5. Prindërit janë të mirëseardhur të sjellin përvoja profesionale për mbajtjen e ligjëratave ose organizimin e aktiviteteve tjera mësimore e jashtëmësimore.
6. Në rast të thyerjes së rregullave të shkollës nga nxënësit, prindërit duhet të bashkëpunojnë me kujdestarët dhe stafin e shkollës për masat edukative e disiplinore të përcaktuara me rregullat e shkollës.